



Anxhela Paparizo është profesioniste me formim ndërkombëtar në fushën e menaxhimit. Paparizo ka përfunduar studimet në Shqipëri në degën Gazetari dhe master në Histori. Më pas ka ndjekur studimet për Planifikim Kulturor pranë University of British Columbia, një nga universitetet më të njohura në Kanada, si edhe Programin e Lidershit Ekzekutiv në Ivey Business School, program i fokusuar në zhvillimin e aftësive drejtuese dhe menaxhimin strategjik.

Gjatë karrierës së saj profesionale është angazhuar në role drejtuese dhe administrative, duke kontribuar në menaxhimin institucional, koordinimin e projekteve dhe zhvillimin e proceseve organizative. Përvoja e saj ndërthur formimin akademik me aftësitë në leadership, komunikim institucional dhe menaxhim ekipesh.

Më herët Paparizo ka mbajtur pozicionin e kryetares së Këshillit Koordinues të Diasporës për Kanadanë.

Që prej datës 23 shtator 2025, mban detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, institucioni më i madh universitar dhe terciar shëndetësor në Shqipëri. Në këtë rol, Paparizo drejton proceset administrative dhe strategjike të institucionit, me fokus në përmirësimin e shërbimeve spitalore, modernizimin e infrastrukturës dhe forcimin e standardeve të kujdesit ndaj pacientit.